

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR
“Torrnado & Meze”**

Sot, më datë **04.12.2024**, bazuar në ligjin Nr. 9901 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe në ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e binesit” i ndryshuar, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“Torrnado & Meze”**.

Themeluesit e shoqërisë janë:

- Gazment Nona**, atësia Fejzi, amësia Rahime, shtetas shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi I01231043Q, i datëlindjes 31/12/1980, lindur në Lapardha dhe banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- Mikel Nona** atësia Fjezi, amësia Rahime, shtetas shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi I30503065I, i datëlindjes 03/05/1983, lindur në Lapardha dhe banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

KREU I

**EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI, VULA, LOGO E
SHOQËRISË DHE LLOGARITË BANKARE**

**NENI 1
EMRI I SHOQËRISË**

1.1. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“Torrnado & Meze”** (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

**NENI 2
SELIA**

- Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rr. Plazhi 13, Shkalla:0 ndodhur në ZK 8518, nr. pasurie 39/306, vol. 102, fq. 79, me sipërfaqë ndërtësë 109 m², Durrës.**
- Adresa e postës elektronike për komunikimin elektronik është: mikelnona83@gmail.com.
- Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brënda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

Faqe 1 e 11

Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
Torrnado & Meze

NENI 3 KOHËZGJATJA

3.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1. Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktivitetave që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtorjë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar në:

Bar-Kafe, Restoran, fast-food, shërbim katëring, si dhe çdo shërbim tjetër në fushën e restorantit.

4.2. Për përbushjen e objektit të saj Shoqëria:

- Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitetet e njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;
- Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë trualli apo objektesh.
- Mund të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në; ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe të tretëve, veprime me pasuri të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/së burimeve nëpërmjet shqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

4.3. Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përbushë ose të jetë i dobishëm për përbushjen e objektit të saj.

NENI 5 VULA, LOGO E SHOQËRISË DHE LLOGARITË BANKARE

5.1. Shoqëria ka vulën e saj dhe logon e saj, me mbishkrimin e emrit të shoqërisë: “**Torrnado & Meze**”.

5.2. Ajo ka llogarinë e saj bankare në lekë e valuta të tjera në Bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

KREU II

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

NENI 6 KAPITALI I SHOQËRISË

6.1. Kapitali fillestari i shoqërisë është 10,000 (dhjetëmijë) Lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota. Kapitali i shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortakët që zoterojnë 100 % (njëqind për qind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht:

- **Gazment Nona**, atësia Fejzi, amësia Rahime, shtetas shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi I01231043Q, i datëlindjes 31/12/1980, lindur në Lapardha dhe banues në Durrës, **i cili zoteron 50% të kapitalit**, me vlerë nominale 5.000,00 (pesëmijë) lekë lekë.
- **Mikel Nona** atësia Fjezi, amësia Rahime, shtetas shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi I30503065I, i datëlindjes 03/05/1983, lindur në Lapardha dhe banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **i cili zoteron 50% të kapitalit**, me vlerë nominale 5.000,00 (pesëmijë) lekë.

6.2. Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të shoqërisë ortakët do të kenë të drejtët e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesët im të drejtë me pjesëmarrjen që zoteron secili në kapitalin e shoqërisë.

NENI 7 KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT

7.1. Në rast se një ortak apo bashkëzotëruesh i një kuote humb jetën, trashegimtaret e tij do të janë të vetmit persona që do t'i njihet titulli mbi kuotën nga shoqëria; por asnjë nga këto parashikime nuk çliron përgjegjësinë e trashegimtareve nga çdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Në rastin e vazhdimit të Shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut që ka humbur jetën, trashegimtaret duhet të caktojnë një përfaqësues të përbashkët.

7.2. Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës së falimentimit të një ortaku mund të zgjedhë të bëhet zotëruesh i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nësë personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëruesh i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nësë personi i mësipërm zgjedh të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër atëherë ai duhet ta kryejë atë nëpërmjet një akti të vlefshëm të transferimit të kuotës.

7.3. Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesh i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit të regjistrin tregëtar si zotëruesh i kuotës.

NENI 8 **ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

8.1. Kapitali shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar pér kontributet në para dhe me anët e kontributeve në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar pér këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak pér të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

8.2. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendime në të njëjtat kushte që kerkohen pér ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 9 **TRANSFERIMI I KAPITALIT**

9.1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesë të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesë të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

KREU III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 10 **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

10.1. Asambleja e Përgjithshme është Organi vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet pér të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

10.2. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij, si dhe të votojë ne përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.

10.3. Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me

Faqe 4 e II

Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
Torrnado & Meze

prokurë me shkrim.

10.4. Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.

10.5. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjetëve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call, audio ose video) në përputhje me legjislacionin për tregtaret dhe shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë Së Përgjithshme duhet të mbahet në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.

10.6. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/et ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të Kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara, të paktën 15 (pesëmbedhjetë) ditë përpëra datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

10.7. Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.

10.8. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.

10.9. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.

10.10. Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e Vtit Financiar.

10.11. Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nësë marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë së 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, përvèç rasteve të parashikuara më poshtë në nenin 10.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.

10.12. Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të 3/4 të ortakëve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zgogrimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 11 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

11.1. Shoqëria administrohet nga një apo me shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhe prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.

11.2. Administratori zoteron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përvèç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.

11.3. Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.

11.4. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti intëresi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

11.5. Administratori i Shoqërisë do të jetë:

- **Z. Mikel Nona**, atësia Fjezi, amësia Rahime, shtetas shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi I30503065I, i datëlindjes 03/05/1983, lindur në Lapardha dhe banues në Durrës, për një periudhë kohore deri në 03.12.2029.

NENI 12 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

12.1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paraljmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

Faqë 6 e 11

Akti i Themelimit dhe Statutit i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
Torrnado & Meze

- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g) raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 12.2. Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asambleën e Përgjithshme, në rastet kur:
- i) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - j) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - k) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 12.3. Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 12.4. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 13 PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

- 13.1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 13.2. Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 13.3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 13.4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

13.5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

13.6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- f) u kthen ortakëve kontributet;
- g) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- h) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- i) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- j) jep kredi.

13.7. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

13.8. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

NENI 14 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

14.1. Asambleja e Përgjithshme përcakton shpérblimin e Administratorit të Shoqërisë.

NENI 15 PËRFUNDIMI I DETYRËS SË ADMINISTRATORIT

15.1. Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- (a) i përfundon mandati;
- (b) shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
- (c) jep dorëheqjen nga detyra duke njofuar Shoqërinë;
- (d) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
- (e) mungon pa arsyë në detyrë për më shumë së 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vundos ta shkarkojë nga detyra.

KREU V

KONTROLLI FINANCIAR I SHOQËRISË, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI

NENI 16 KONTROLLI FINANCIAR

16.1. Kontrolli finansiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspert Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 16 VITI FINANCIAR

17.1. Viti finansiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit të shoqërisë, i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe mbylljet në fund të këtij viti.

17.2. Si rregull veprimet ekonomike të Shoqërisë mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti, përjashtim nga ky rregull do të bëhet kur kërkon organi kompetent ligjor.

17.3. Veprimtaritë ekonomike dhe financiare të shoqërisë mbyllen më datë 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori i shoqërisë nxjerr bilancin kontabël dhe raportin përkatës në përputhje me dispozitën ligjore dhe kontabilitetin.

17.4. Raporti i administrimit, inventaret, bilancet dhe llogaritë vjetore të hartuara i nënshtronen pa përjashtim miratimit nga Asambleja e ortakëve brenda afateve të caktuara.

17.5. Me miratimin e bilancit kontabël shoqëria vendos përfondet e nevojshme për zhvillimin, si p.sh fondi rezervë, akte të akumulimit, investimit, etj.

NENI 18 BILANCI VJETOR

18.1. Bilanci vjetor, Pasqyrat Financiare, Inventari, Raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nësë janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet përmiratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.

18.2. Dokumentat që kanë të bëjnë me vitin finansiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finansiar.

**NENI 19
DIVIDENTI**

19.1. Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë të Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatesë të ortakëve.

19.2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendët duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjitha dividendët do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumat e paguara mbi kuotat gjatë çdo pjese ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividendi.

**NENI 20
RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT**

20.1. Në selinë e shoqërisë tregtare mbahet dokumentacioni i plotë i saj, mbahen protokollet e ndryshme, dokumentacioni i kontabilitetit ku mund të bëhet vetëkontroll ose për t'ia vënë në dispozicion çdo organi kontrolli ta ngarkuar me ligj. Dokumentet e shoqërisë duhet të njoftohen mirë nga ortakët

KREU VI

**PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHËM,
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

**NENI 21
PRISHJA DHE LIUIDIMI I SHOQËRISË**

21.1. Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

**NENI 22
LIGJI I ZBATUESHËM**

22.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

Faqe 10 e 11

Akti i Themelimit dhe Statutit i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
Tornado & Meze



NENI 23
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHEJVE

23.1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësish ndërmjet palëve të intëresuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
Torrnado & Meze**

GAZMENT NONA

MIKEL NONA

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

GAZMENT NONA



MIKEL NONA



Faqe II e II

*Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
Torrnado & Meze*